



Termtat e References

Konsulent/e & facilitator/e për nevoja të projektit “Angazhimi i të mbijetuarve”

Titulli i Punës: **Konsulent/e & Facilitator/e** (1 pozitë)

Titulli i Projektit: Angazhimi i të mbijetuarve

Donatori: IRCT

Përfituesit: personat apo organizatat që punojnë me të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës: profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe psikologjik, punëtorët social, juristët, përfaqësues nga komuniteti etj.

Vendi i Projektit: Republika e Kosovës

Organizata Implementuese: Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)

Kohëzgjatja e projektit: qershor 2024 – qershor 2025

Për: Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)

QKRMT është një organizatë jofitimprurëse e përkushtuar në eliminimin e dhunës dhe torturës. Mandati i saj është të mbrojë, avancojë dhe advokojë për të drejtat dhe lirinë themelore të mbijetuesve të torturës dhe formave të tjera të dhunës. QKRMT përpjeket të arrijë misionin e saj përmes rehabilitimit holistik, fuqizimit shoqëror-ekonomik, advokim ligjor për reforma ligjore dhe institucionale, ngritje të ndërgjegjësimit, ndërtimit të kapaciteteve, dhe realizimit të veprimtarive dokumentuese dhe hulumtuese.

Për më shumë informacion vizitoni: <https://krct.org/>

QKRMT, me mbështetjen e Këshillit Ndërkombëtar për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (IRCT), po implementon projektin “Angazhimi i të mbijetuarve”

Projekti synon të rrisë angazhimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në avokim dhe shërbime rehabilitimi si dhe të shtojë ndjenjën e tyre të agjencisë në rrugëtimin e tyre drejt rehabilitimit, dëmshpërblimit dhe drejtësisë. Përmes projektit synohet të ndikohet në nivel individual që të mbijetuarit të mund të angazhohen në mënyrë aktive dhe të vazhdojnë jetën normale; nivel të sistemit: që personeli i organizatave kombëtare dhe rajonale të zhvillojë kapacitetet e tyre dhe të identifikojë strategji për angazhimin e të mbijetuarve, dhe në nivelin shoqëror duke rritur vetëdijen për rolin dhe rëndësinë e angazhimit të të mbijetuarve për realizim të qëllimeve të tyre dhe kontributit në përkrahje të shtuar.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të sigurojë që të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës të angazhohen aktivisht në reparacion dhe qasje në drejtësi dhe në nivelin kombëtar dhe rajonal, të ketë një rritje në shkëmbimin e përvojave që do të ndikojë në forcimin e kapaciteteve të organizatave për të siguruar hapësirë të sigurt për të mbijetuarit. Në kuadër të projektit, objektiva “Përfshirje e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në arritjen e së drejtës për reparacion dhe qasje në drejtësi” parashikon, ndër të tjera edhe:

- Publikimin e një fletëpalosjeje informative për angazhimin e të mbijetuarve



Objektiva tjetër e projektit parashikon krijimin e një platforme kombëtare dhe rajonale të shkëmbimit për angazhimin e të mbijetuarve. Në kuadër të kësaj objektive parashikohen aktivitetet në vijim:

- Organizimi i një punëtorie kombëtare-rajonale për shkëmbim të përvojave për angazhim të të mbijetuarve, dhe
- Krijimi i një platforme të shkëmbimit mes organizatave të ngjashme

Fokusi i Punës

Konsulenti/ja & Facilitatorja do të punojë në:

1. Përpilimin e një fletëpalosjeje informuese për angazhimin e të mbijetuarve;
2. Facilitimin / lehtësimin e një punëtorie kombëtare – rajonale për të ndarë përvojat lidhur me angazhimin e të mbijetuarve; dhe
3. Krijimin e një platforme të shkëmbimit të informatave / përvojave me organizata të ngjashme kombëtare dhe/ose rajonale.

Rezultatet e pritura

Pritet që konsulenti/ja & facilitatori/ja të dorëzojë:

1. Një draft fillestar të fletëpalosjes për angazhim të të mbijetuarve dhe pas komenteve nga QKRMT të dërgojë një draft final të fletëpalosjes
2. Një draft koncept dhe draft agjendë të punëtorisë dhe pas komenteve nga QKRMT ta përpunojë dokumentin duke i përfshirë komentet
3. Një agjendë të hollësishme të punëtorisë
4. Të facilitojë/lehtësojë punëtorinë dy ditore
5. Të dërgojë një raport narrativ të punëtorisë, përfshirë një listë me organizatat e ngjashme që do të bëhen pjesë e platformës për shkëmbim të informatave / përvojave

Kohëzgjatja

Procesi i kryerjes së punëve duhet të përfundojë në periudhën nga 1 shkurt 2024 deri më 30 qershor 2024.

Kualifikimet dhe Përvoja

Të pakten 5 vite përvoja të përgjithshme profesionale, në psikologji, mjekësi, apo shkenca sociale. Njohuri të proceseve të angazhimit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës apo të mbijetuarve të torturës në përgjithësi.

Përvojë në përpilim të dokumenteve / materialeve informuese, raporteve, si dhe facilitimit/lehtësimin të punëtorive apo ngjarjeve tjera me pjesëmarrje rajonale/ndërkombëtare.

Përvoja paraprake me të mbijetuar apo me organizata që merren me të mbijetuar të torturës konsiderohet përparësi.

Bashkëpunimi dhe Komunikimi

Pritet që konsulenti/ja & facilitatori/ja të bashkëpunojë ngushtë me palët e interesuara të projektit dhe të sigurojë përditësime të rregullta për progresin dhe sfidat gjatë procesit të punës. Pritet që konsulenti/ja & facilitatori/ja të jetë i/e disponueshëm/me për konsultime virtuale ose direkte sipas nevojës.

Buxheti

Ka një buxhet të caktuar për këtë shërbim të ofruar, duke përfshirë pagesë konkurruese në përputhje me ekspertizën dhe përvojën.



Kohëzgjatja

Aktivitetet e mësipërme duhet të kryhen sipas afatit më poshtë:

28 shkurt 2024 – drafti i parë i konceptit dhe agjendës së punëtorisë

29 shkurt 2024 – dërgimi i draftit të parë të fletëpalosjes

15 mars 2024 – drafti final i fletëpalosjes me komentet të përfshira

20 mars 2024 – drafti final i konceptit dhe agjendës së punëtorisë me komentet të përfshira

30 prill 2024 – agjenda e hollësishme e punëtorisë dy ditore

22 – 23 maj 2024 – facilitimi/lehtësimi i punëtorisë dy ditore

15 qershor 2024 – dërgimi i raportit narrativ të punëtorisë, përfshirë një listë me organizatat e ngjashme që do të bëhen pjesë e platformës për shkëmbim të informatave / përvojave

Dërgimi i Propozimit

Aplikimet duhet të dorëzohen deri më 30 janar 2024 tek info@krct.org

Propozimi duhet të përfshijë:

- 1) CV të detajuar që thekson eksperiencën relevante.
- 2) Shembuj të punës së mëparshme në një fushë të ngjashme.

Ne vlerësojmë angazhimin tuaj në këtë çështje të rëndësishme. Nëse keni ndonjë pyetje ose nevojë për sqarime të mëtejshme, mos ngurroni të na kontaktoni.

